



DPK/DMP
01

03-179/2013
28.01.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 18217/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Rexhep Boja nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73, 74, 195, 199, si dhe neni 10 të LMK me dt. 28.12.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Rexhep Jashar Boja, i lindur më 20.06.1946 në fsh. Kernic K. Klinë, tani me vendbanim në Prishtinë rr. Bajram Kelmendi nr.41, me profesion ambasador në Arabin Saudite, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtarit të lartë publik, ambasador në Arabin Saudite, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili behetë me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit Me këtë ka kryer veprën kundërvajtës nga neni 8 paragrafi 1 dhe i sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par. 1 pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë shqiptohet:

Q O R T I M

Shpenzime të procedurës nuk ka patur,

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr.01 -1817/2012 të dt 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marrë Konkluzion. Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i përket mbushjes së formularit për deklarimin pasurisë është se nuk kam pas ndonjë qellim që të deklarim të pasurisë time që e kam por arsyet janë se në cilësinë e ambasadorit që e kam në Arabin Saudite kompas shumë aranzhime të delegacioneve nga Kosova, ashtu e nga kjo agjent nuk kam pas kohë të mjaftueshme që të merrem apo edhe të vi në Kosovë për ta mbushur formularin për deklarimin e pasurisë, ndërsa sa i përket pranimit fizik të formularit nuk me është dërguar nga ana e Ministrisë apo pika kontaktuese e Ministrisë, ndërsa sa i prekët imell adresës e kam pa me dt. 18.04.2012 kur kam ardh në Kosovë, dhe të nesërmen menjëherë e kam mbushur këtë formular dhe e kam Agjensionin ku mund të japë jepi vërtetimin me të cilën e kam derzuar, do të thotë arsyeja e mos deklarimit kanë qenë vetëm mos pranimit formularit dhe mos njohuria që ta mbushi formularin për mes imeles, edhe pse kam pas shumë probleme që nuk kanë punuar imell adresa pasi që shpesh na i nderojnë edhe kodet.

Andaj gjyqtari pas administrimit të provave dhe të provuarit të kësaj çështje me të drejtë dhe në mënyrë të plotë vërtetoi gjendjen faktike se pandehuri ka kryer kundërvajtje, i cili u shpall përgjegjës dhe ju shqiptoi Masa QORTIM pasi që u konstatua se ekzistojnë rrethana, të cilat në masë të konsideruar e zvogëlojnë përgjegjësinë e kryesës të kundërvajtjes, pasi që i njëjti nuk e kishte pranuar formularin në mënyrë fizike, ku i njëjti në mënyrë elektronike e ka pranuar por nuk kishte hapur pasi që në vendet ku ka qenë gjatë kësaj kohe ka pas pengesa të mëdha elektronike, edhe pse nuk e mohonte se ju është dërguar formulari përmes imeles, po ashtu pasi që i njëjti e ka kuptuar kërkesën për mbushjen e formularit, i njëjti menjëherë kishte ardh në Kosovë dhe kishte mbushur formularin dhe e kishte derzuar me dt. 18.04.2012 i cili nuk ka pas qellim që të shmanget mos mbushjes së këtij formulari. andaj mund të pritët që edhe pa dhënien e dënimin, i njëjti në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtylla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Ratmir Bohram

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.